



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0210

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahimimi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE " AUTOTRADE " SH.P.K., kundër vendimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së-Ritender" me numër të prokurimit 214/30400-25-7580-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 14/05/2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e " AUTOTRADE " SH.P.K. me nr. 2026/0210 , e datës 03/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së-Ritender", me numër të prokurimit 214/30400-25-7580-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – POLICIA E KOSOVËS.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS për aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së-Ritender", me numër të prokurimit 214/30400-25-7580-1-1-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4 dhe 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.08.2025 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-se-Ritender" me nr. të prokurimit:

"214/30400-25-7580-1-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 400,000.00€.

Me 13.03.2026 POLICIA E KOSOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin për kontratë (B58), ku është rekomanduar për kontratë AUTOTRADE " SH.P.K.

Me 17.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 26.03.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.04.2026, OE " AUTOTRADE " SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0210, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder anulimit të aktivitetit të prokurimit .

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "AUTOTRADE " SH.P.K.janë parashtruar si në vijim:

Neni 1 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 52 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 60 i LPP-së Neni 62 i LPP-së Neni 72 i LPP-së Neni 40 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 43 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Vendimi i OSHP-së nr. 2025/1157.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 1, pasi qëllimi i aktivitetit është marrja e shërbimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga operatorët ekonomik që marrin pjesë ose interesohen në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë transparence dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Ky pretendim i OE është i pabazuar.

- AK nuk e ka shkelur Nenin 7 të LPP-së, pasi të gjithë OE janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike. Po ashtu, AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure. AK ka hartuar specifikat teknike të cilat janë në harmoni me LPP dhe nuk kanë asnjë kufizim apo favorizim dhe ofertat e juaja janë trajtuar në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes dhe specifikat teknike. Andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

- AK nuk ka shkelur Nenin 52 – Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës. AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka përcaktuar kriteret kualifikuese dhe kriterin për dhënie të kontratës, ku kriter për dhënie të kontratës ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Andaj AK ka respektuar Nenin 52 dhe ka rekomanduar për anulim aktivitetin e prokurimit sepse të gjitha ofertat janë të përgjegjshme.

- OE ka ofertuar çmime shumë herë më të larta se ato reale në treg. Duke iu referuar nenit 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e cila thotë se gjatë administrimit të procedurave të prokurimit Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut, ju keni ofruar çmime shumë herë më të larta se çmimet reale të tregut. Duke iu referuar ofertës financiare, OE ka ofruar çmime shumë herë më të larta për artikujt e poshtëshënuar se sa vlera reale e tregut dhe vlera e planifikuar nga ana e AK, e cila është caktuar duke u bazuar në hulumtim të tregut dhe në kontratën e cila është ende aktive për këtë aktivitet.

Po ashtu, duke iu referuar edhe interpretimit të KRPP-së, AK në harmoni të plotë me LPP ka kërkuar sqarime gjatë fazës së parë të vlerësimit mbi çmimet shumë herë më të larta se ato reale në treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim, program të OE, por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri tek formulimi i këtyre çmimeve.

- Pjesa A: Pz.1, Pz.3, Pz.5, Pz.10, Pz.11, Pz.12, Pz.13, Pz.14, Pz.15, Pz.19, Pz.20, Pz.21.

- Pjesa B: Pz.32, Pz.49, Pz.50, Pz.51, Pz.62, Pz.74, Pz.81, Pz.83, Pz.84, Pz.88, Pz.89, Pz.101, Pz.102, Pz.105, Pz.108, Pz.109, Pz.113, Pz.114, Pz.115, Pz.116, Pz.117, Pz.118, Pz.120.

- Pjesa C: Pz.121, Pz.122, Pz.123, Pz.130, Pz.133, Pz.145, Pz.149, Pz.150, Pz.152, Pz.162, Pz.163, Pz.164, Pz.165, Pz.167, Pz.172, Pz.173, Pz.174, Pz.175, Pz.180, Pz.182, Pz.183, Pz.184, Pz.185, Pz.186, Pz.187, Pz.188, Pz.189, Pz.190, Pz.191, Pz.192, Pz.193, Pz.194, Pz.195, Pz.196, Pz.204, Pz.210.

Prandaj ky pretendim i OE është i pabazuar.

- Bashkangjitur gjeni listën e vlerës së parashikuar të AK-së, çmimin për njësi të dhënë nga OE dhe krahasimin në mes tyre të shprehur në përqindje (%) për artikujt e lartpërmendur.

- AK nuk ka shkelur Nenin 59 dhe Nenin 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (Rregullorja nr. 004/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik). Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme. Andaj AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjitha ofertave në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat.

- Oferta juaj është e papërgjegjshme për pikat në vijim:

Sipas nenit 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024, AK duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Ju keni ofruar çmime shumë më të larta se çmimet reale të tregut dhe çmimet e parashikuara nga AK, të cilat janë planifikuar mbi bazën e hulumtimit të tregut dhe kontratës ekzistuese për artikujt e njëjtë.

Po ashtu, duke iu referuar interpretimit të KRPP-së, AK ka kërkuar sqarime dhe OE nuk ka ofruar dëshmi bindëse për formulimin e çmimeve.

Sa i përket pretendimit se komisioni i rivlerësimit nuk ka kërkuar sqarime, AK sqaron se sqarimet janë kërkuar nga komisioni i vlerësimit dhe komisioni i rivlerësimit vetëm i ka analizuar ato.

- AK nuk ka shkelur Nenin 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës. Oferta juaj është e papërgjegjshme për shkak të çmimeve shumë të larta, të cilat nuk përputhen me vlerat e tregut dhe planifikimin e AK. Prandaj ky pretendim është i pabazuar.

- AK nuk ka shkelur Nenin 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe Nenin 43 të Rregullores 02/2022 (RRPP 004/2024). AK ka anuluar aktivitetin pasi është plotësuar kushti që asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme.

- Si përfundim, AK nuk ka shkelur asnjë nga nenet e lartcekura dhe gjatë rivlerësimit ka respektuar të gjitha dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor. Pretendimet ankimore të OE janë të pabazuara.

- AK nuk ka shkelur Nenin 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, pasi ka kërkuar dhe pranuar sqarime nga OE, por ato nuk kanë qenë bindëse.

- Pretendimi se AK ka shkelur vendimin e OSHP-së (neni 131 i LPP-së) është i pabazuar, pasi AK e ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe ka vepruar në përputhje me vendimin.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 03.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0210, ndërsa me datë 17.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0210, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i AK . Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është përgjigjur rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "AUTOTRADE " SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0210 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, i pakënaqur me Vendimin (B58) të AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ka parashtruar ankesë në OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë rivlerësimin duke u bazuar në dispozitat e LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK, pas pranimi të vendimit Nr. 1157/2025, ka formuar komisionin për rivlerësimin e ofertave dhe, pas përfundimit të rivlerësimit, e njofton OE ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar, i cili eliminohet me arsyetimin si më poshtë:

Lidhur me arsyen e eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se vlerësimin lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues e ka dhënë në raportin paraprak të ekspertizës me nr. 1157/25, të datës 11.12.2025, prandaj i propozon panelit shqyrtues që këtë lëndë ta trajtojë si çështje të gjykuar, sipas dispozitave të Rregullores së punës së OSHP-së, sepse autoriteti kontraktues, pas pranimi të përgjigjes së dhënë komisionit paraprak, ka vepruar dhe ka vlerësuar se përgjigjet nuk janë bindëse për AK-në dhe se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e nenit 61.4 të LPP-së, i cili përcakton që:

Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jonormalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

Sipas paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së, eksperti shqyrtues sqaron se vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues dhe, njëherësh, vlerëson se AK i ka zbatuar procedurat e parapara në nenin 61 të LPP-së dhe Rregullores për çmime jonormalisht të ulëta.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka pasur nevojë të mbahet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat lidhur me rastin ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli Shqyrtues evidenton se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka nxjerr edhe një vendim paraprak me nr. 1157/25 të datës 11.12.2025. Në këtë vendim janë konstatuar shkeljet e autoritetit kontraktues i cili nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të NJK dhe DT, me çrast lënda është kthyer në ri-vlerësim me qëllim të përmirësimit të këtyre pa rregullsive të bëra gjatë vlerësimit. Megjithatë, AK ka kthyer lëndën në ri-vlerësim duke kërkuar sqarime rreth çmimeve të OE ankues, por megjithatë prap komisioni i vlerësimit nuk është

bindur me ato sqarime duke eliminuar prapë OE ankues dhe duke anuluar në tërësi këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj, Autoriteti Kontraktues (AK), gjatë ri-vlerësimit në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciues e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish vendimin e saj bazuar në gjetjet e vendimeve paraprake të OSHP dhe Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, AK prapë e konsideron ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme dhe nuk i konsideron çmimet e ankuesit si çmime të tregut.

Andaj, Paneli shqyrtues përfundimisht, bazuar në të lartcekurat sqaron se kjo çështje sipas këtyre pretendimeve tani më konsiderohen të trajtuara, bazuar në nenin 105, paragrafi 2.15, të Ligjit për Prokurimet Publike (LPP), i cili parashikon se në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues duke u nisur nga neni 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik*”. Detyrohet të marrë parasysh parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme dhe përgjegjësisia për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave i mbetet vet Autoritetit Kontraktues në këtë rast.

Kështu që. PSH vendos ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i njëjtë i cili i prinë edhe një vendimi paraprak që është nxjerrë nga komisione të vlerësimit të cilët supozohen të jenë profesionale dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar “*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*”. Atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet më tutje ky aktivitet të prokurimit dhe në zbatim të nenit 6 të LPP, paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe vlerësimi i ofertave si dhe zhvillimi i kësaj procedure.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet prapë në ri-vlerësim.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në

përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës, Paneli konsideron se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por e pa mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit ta kthej sërish në ri-vlerësim dhe të prolongoj aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-së-Ritender”, me numër të prokurimit 214/30400-25-7580-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - " AUTOTRADE " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: